



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTRATVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

Në bazë të Planit dhe të programit të rishikuar të gjuhës rome me elemente të kulturës dhe të historisë, si lëndë zgjedhore, dhe të udhëzimit administrativ nr.7/2010, të datës 21.06.2010, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë shpall

T E N D E R

për shtëpitë botuese të cilat sigurojnë tekstet shkollore për këto klasë

1. Teksti shkollor për gjuhën rome për klasën II;
2. Tekst shkollor për gjuhën rome për klasat III-IV;
3. Tekst shkollor për gjuhën rome për klasën V;
4. Tekst shkollor për gjuhën rome për klasat VI-VII;
5. Tekst shkollor për gjuhën rome për klasat VIII-IX.

KUSHTET

1. Të drejtë pjesëmarrjeje në këtë tender kanë shtëpitë botuese që merren me botimin e teksteve shkollore dhe që nuk ndiqen penalisht për shkeljen e normave ligjore në fushë të veprimtarisë botuese (sidomos të shpërdorimit të së drejtës së autorëve);

2. Dorëshkrimet duhet t'i përmbushin këto kritere: të ofrojnë informacionet kryesore për nxënie të njohurive në përputhje me Planin dhe programin e gjuhës rome, të kulturës dhe të historisë së këtij grupi etnik, të ofrojnë një qasje sa më të re metodologjike të mësimnxënies, lënda e mbarështruar të shoqërohet me aparaturë sa më të përshtatshme pedagogjike që të nxisë kureshtjen e nxënësve dhe t'i motivojë ata për punë të pavarur dhe krijuese, kurse shkrimi (lloji i fjalisë, gjatësia e fjalisë etj.) të jetë i përshtatshëm për moshën e nxënësve.

3. Shtëpitë botuese konkurrojnë me dorëshkrime të nënshkruara me shifër;

4. Dorëshkrimet (e kompletuara e të shtypura në tri kopje) duhet të përmbajnë ilustrimet ose idetë për ilustrime;

**Dorëshkrimet dorëzohen në MASHT, adresa Rr. “Agim Ramadani”,
në zyrën e teksteve shkollore.**

Tenderi mbetet i hapur tre muaj pas shpalljes së tenderit në media.